



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale
Mbledhja Nr. 01
Ndërtesa e Kuvendit, salla N - 302
Prishtinë, më 10 tetor 2017, në orën 11:00

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR SHËNDETËSI, PUNË
DHE MIRËQENIE SOCIALE

Në mbledhje morën pjesë: Besa Baftiu, Enver Hoti, Miljana Nikoliq, Fatmire Kollqaku-Mulhaxha, Haxhi Avdyli, Naser Rugova, Flora Brovina, Bekim Haxhiu, Time Kadrijaj dhe Fikrim Damka.

Mungoi: Faton Topalli.

Pjesëmarrës të tjerë: Shpend Qamili – UNDCO/UNKT, Ervin Ibrahim – UNKT dhe Ardianë Halimi -LVV.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Shpresa Haxhijaj, koordinatore e Komisionit dhe Muhamet Bytyçi, zyrtar i fushës.

Mbledhjen e kryesoi, Besa Baftiu, kryetare e Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky:

REND I DITËS

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Konstituimi i Komisionit;**
- 3. Të ndryshme.**

***Kryetarja** konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.*

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa asnjë ndryshim.

Kryetarja **Besa Baftiu**, pasi i përshëndeti të gjithë, duke iu dëshiruar punë të mbarë në këtë mandat, tha se Komisioni për Shëndetësi Punë dhe Mirëqenie Sociale, është një shembull i mirë i bashkëpunimit pa dallime partiake. Shfrytëzoj rastin t'i përshëndes dhe t'i falënderojë ish-kryetaren e Komisionit, zonja Brovina dhe ish-nënkryetarin z. Damka për angazhimin dhe punën që kanë bërë si udhëheqës të komisionit, e të cilët janë sërish në këtë komision. Besoj se do të jenë bashkëpunëtorë shumë të ngushtë edhe do të më ndihmojnë që në atë frymë të bashkëpunimit ta udhëheq edhe unë së bashku me dy nënkryetarët e këtij komisioni.

2. Konstituimi i Komisionit

Pra, kjo mbledhje më tepër është e karakterit konstituiv, njohjes ndërmjet veti, e në veçanti të njihemi me anëtarët e rinj të komisionit. Besoj shumë se do të kemi një bashkëpunim të mirë ndërmjet veti pa dallime partiake. Pa një bashkëpunim të ndërsjellë nuk do të ketë sukses as komisioni, me vjen mirë që në mesin tonë kemi anëtarë të profesionit të doktorit dhe profesioneve të tjera të cilët i njohin mirë këto çështje dhe së bashku do t'ia dalim, theksoi Baftiu.

Besa Baftiu tha se unë jam për të dytën herë radhas deputete e Kuvendit të Kosovës. Edhe në mandatin e kaluar kam qenë pjesë e këtij komisioni, andaj konsideroj që jam njohëse e mirë e problematikës, si në aspektin shëndetësor, ashtu edhe atë të çështjeve sociale. Me profesion jam mjeke pediatre për fëmijë të porsalindur dhe punoj në spitalin rajonal në Gjilan. Andaj kërkoi edhe nga ju nga një prezantim të shkurtër.

Enver Hoti fillimisht e falënderoi kryetaren, duke i përshëndetur ju uroj suksese gjithë anëtarëve të komisionit. Shpresojmë dhe urojmë që ne, si komision, të punojmë shumë për përmbushjen e detyrave dhe përgjegjësiave tona. Shpresoj shumë se do të kemi një bashkëpunim të mirë dhe t'i iniciojmë apo adresojmë çështjen që janë me interes për qytetarin, bashkëpunimi ndërmjet nesh s'do të mungojë po ashtu edhe sukseset. Faleminderit!

Miljana Nikoliq, përshëndetje për të gjithë! Jam deputete për herë të parë me profesion anesteziologë. Edhe unë ju uroj të gjithëve për mandatin njëherit edhe unë uroj që të kemi një bashkëpunim të mirë si komision. Faleminderit!

Haxhi Avdyli, e falënderoi kryetaren e komisionit duke i përshëndetur ju uroj suksese gjithë anëtarëve të komisionit. Me profesion jam Neurokirurg kam përfunduar edhe studimet pos diplomike për menaxhim shëndetësor. Besoj që përvoja ime në klinikë edhe në spital do të jetë dobiprurëse, si për politikat shëndetësore, edhe për komisionin në përgjithësi. Shpresoj se do të kemi një bashkëpunim të mirë në favor të përmirësimit të sistemit shëndetësor i cili ka pasur probleme në vazhdimësi. Faleminderit!

Naser Rugova, faleminderit kryetare! Ju përshëndes të gjithëve dhe ju uroj suksese për mandatin e deputetit. Jam në mandatin e dytë si deputet dhe uroj që si komision bashkërisht të trajtojmë tema që janë në interes të përgjithshme për shëndetin e popullatës, si dhe një mbikëqyrje parlamentare korrekte të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies sociale, konsideroj se janë dy pika jashtëzakonisht të rëndësishme të sistemit shtetëror. Ju uroj shëndet në radhë të parë dhe uroj që të kemi një bashkëpunim të mirë mes nesh si komision. Ju faleminderit!

Flora Brovina, pasi i përshëndeti të gjithë, duke iu dëshiruar punë të mbarë në këtë mandat, tha se Komisioni për Shëndetësi Punë dhe Mirëqenie Sociale, është një shembull i mirë i bashkëpunimit pa dallime partiake. Sa i përket profesionit si gazetarë për nëntë vite me radhë kam përcjellë çështjet shëndetësore dhe sociale i njoh mirë dhe jam e mishëruar me këto dy ministri. Sa i përket mjekësisë jam pediatre sub-specializim e kam pediatri klinike, si dhe studimet pos diplomike i kam përfunduar në Zagreb. E mbaj çmimin i cili na bënë nderë të gjithëve jo vetëm mua, çmimin e Mjekëve të Botes në Uashington. Ndërsa gjatë kohës së luftës kam udhëhequr shërbimin shëndetësor në kuadër të këshillit emergjent. Ndërkaq prej mandatit të dytë deri të gjashtin jam pjesë e Komisionit për Shëndetësi Punë dhe Mirëqenie Sociale, dhe kjo përvojë do të na shërbejë për të mirë si komision. Ju faleminderit!

Bekim Haxhiu, faleminderit kryetare, njëherit të uroj edhe zgjedhjen si kryetare e komisionit! Po ashtu edhe ju koleg deputet ju uroj për zgjedhjen deputetë në këtë legjislature. Gjithë ashtu falënderoj deputeten Flora Brovina për një udhëheqje të këtij komisioni në mandatin e kaluar edhe pse s'kam qenë anëtar i këtij komisioni unë kam marrë pjesë në disa takime dhe kemi punuar ngushte me këtë komision dhe shfrytëzoj rastin t'i falënderoj gjithë ish -anëtarët e këtij komisioni. Ky është mandati imi i tretë si deputet i Kuvendit të Kosovës me profesion jam doktor i shkencave të fizioterapisë. Ky komision çdoherë ka pasur një bashkëpunim të mirë, uroj që të vazhdojmë edhe në të ardhmen dhe si komision të bëjmë punën tone si është më së miri. Pasi që legjislacioni i dy ministrive ka nevojë të përmirësohet të avancohet normalisht edhe këto dy ministri kanë nevojë për një mbikëqyrje parlamentare të cilën do të bëjmë bashkërisht. Urime suksese!

Fatmire Kollqaku-Mulhaxha, fillimisht e përgëzoj kryetaren, dy nënkryetarët dhe ju gjithë kolegë deputetë të këtij komisionit. Për mua është mandati i dytë në mandatin e parë kam qenë kryetare e këtij komisioni dhe besoj shumë se ajo përvojë do të me ndihmojë në vazhdimin e angazhimit në këtë komision. Ne trajtojmë një problematike shumë të gjerë, pasi që ky komision ka të bëjë me dy ministri shumë të rëndësishme. Unë do të fokusohem në veçanti në monitorimin e zbatimit të ligjeve pasi që ne kemi ligje të shumta, mirëpo nuk po zbatohen si duhet po ashtu edhe në amendamentimin e atyre ligjeve që kanë nevojë për amendamentim. Do të punojmë bashkë edhe në përmirësimin e pozitës së pacientit, por edhe të stafit shëndetësor. Ju faleminderit!

Fikrim Damka, urime kryetare për detyrën e re, kryetare e komisionit! Përshëndes gjithë kolegët deputetë, urime për mandatin! Ky është mandati i tretë si deputet në Kuvendin e Kosovës, një mandat e kam udhëhequr këtë komision, njëherë kam qenë në cilësinë e nënkryetarit. Besoj shumë se mund të kontribuoj në punën e komisionit, po shoh se jemi një ekip e mirë dhe mund të bëjmë shumë punë të mira dhe do të jetë shumë funksional. Besoj shumë se do të vazhdojmë frymën e bashkëpunimit edhe në të ardhmen. Me profesion jam ekonomist. Ju faleminderit!

Time Kadrijaj, urime kryetare për pozitën! Përshëndetje për të gjithë urime për mandatin. Ky është mandati i trete i imi si deputete e Kuvendit të Kosovës në mandatin e parë kam qenë nënkryetare e komisionit, mandej anëtare. Do të vazhdojmë edhe në të ardhmen të kemi një frymë të bashkëpunimit, padyshim se edhe sukseset s'do të na mungojnë. Duhet të punojmë shumë bashkërisht për përmirësimin e mirëqenies sociale edhe shëndetësore të qytetarëve të Kosovës. Po ashtu të bëjmë edhe monitorojmë zbatimin e ligjeve të dy ministrive. Se cili kemi nga nja përvojë menaxheriale dhe besoj shumë se do të ja dalim që të bëjmë punë të mira si

komision. Me këtë përbërje besoj që do të jemi ndër komisionet më të mira, na priftë e mbara gjithë neve. Ju faleminderit!

Kryetarja Besa Baftiu, pasi mori sërish fjalën falënderoi të gjithë për prezantimin dhe deklarin duke theksuar se do të kenë një bashkëpunim të mirë në punën që i pret.

Unë besoj shumë se bashkërisht do të punojmë me qëllim të përmirësimit të gjendjes në këta dy sektorë mjaft të rëndësishëm për jetën e qytetarëve tanë. Me vjen mirë që shumica qenkeni mjekë, por që kemi edhe prej profesioneve të tjera që bashkërisht do të ja dalim. Po ashtu anëtar i këtij komisioni është edhe deputeti Faton Topalli, i cili është njohës shumë i mirë i çështjeve sociale. Atëherë edhe njëherë me lejoni që t'ju falënderojë për gatishmërinë për bashkëpunim në punën dhe angazhimet që na presin si komision.

3. Të ndryshme

Kryetarja, të pika e tretë, të ndryshme, kam paraparë që të diskutojmë lidhur me ditën dhe orën se kur ne, si komision, do t'i mbajmë mbledhjet e komisionit. Pra të kemi një orientim dhe varësisht prej punës apo urgjencave në mundemi edhe të ndryshojmë. Ne bashkërisht po besoj se do të kemi një mirëkuptim, pasi që pjesëmarrja e secilit prej nesh do të jetë evidente në mbledhjet e komisionit.

Kryetarja, pas diskutimeve, konstatoi se Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, nxori këto:

Përfundime:

- Komisioni parimisht vendosi që mbledhjet t'i mbaje gjatë të mërkurave në orën 10.
- Mbledhja e radhës e komisionit të mbahet më: 18.10.2017, ditë e mërkurë, në orën 10:00. Ku do të ftohet ministri i Ministrisë së Shëndetësisë, z. Uran Ismaili, takim i cili do të jetë i karakterit njoftues në mes të komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale dhe Ministrin të Ministrisë së Shëndetësisë. Po ashtu nga ministri të kërkojmë që të bëjë një prezantim nga ana e tij lidhur me sfidat dhe prioritetet apo objektivat që ka si Ministër i Shëndetësisë.
- Kurse mbledhjen tjetër të radhës të ftohet ministri i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, z. Skënder Reçica, takim njoftues në mes të komisionit dhe ministrit. Po ashtu nga ministri të kërkojmë që të bëjë një prezantim nga ana e tij lidhur me sfidat dhe prioritetet apo objektivat që ka si ministër i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale.
- Të fillojmë me përgatitjen e planit të punës për këta tre muaj të vitit 2017, që na ka mbetur tetor, nëntor e dhjetor.

Mbledhja përfundoi në orën 11:45.

E përqatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetarja e Komisionit,

Besa BAFTIU